



HYSENI & ASSOCIATES
LAW FIRM

**KONTRATË DHURIMI
PASURI E LUAJTSHME**

NAMIK HYSENI

Dhe

ALKET HYSENI



Tiranë më, 25/10/2024

KONTRATË DHURIMI KUOTASH

Z. Namik Hyseni, i biri i Myslymit, i datëlindjes 05/08/1941, lindur në Tepelenë dhe banues në Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit me nr. 035309316 dhe numër personal E10805220L, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar;

(që këtu e më poshtë do të quhet **DHURUESI**)

dhe

Z. Alket Hyseni, i biri i Namikut, i datëlindjes 12/05/1974, lindur në Levan, Tepelenë dhe banues në Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit me nr. 035306158 dhe numër personal H40512162M, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

(që këtu e më poshtë do të quhet **PRANUES I DHURIMIT**)

MEQËNËSE:

- A. Dhuruesi z. Namik Hyseni është bashkëortak dhe zotërues i 1 (një) kuote e përbër prej 49% (dyzet e nëntë përqind) të kapitalit të shoqërisë tregtare "H&A Law Firm" sh.p.k, një shoqëri e themeluar e që funksionon sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, e regjistruar ne Regjistrin Tregtar Shqiptar me NIPT L32319015I, me seli ne adresën: Tirane, Rruga e Barrikadave, Godina "Turdiu Center", Kati 6, Ap.4 (me poshtë referuar "**Shoqëria**"), vlera e kapitalit te se ciles eshte 100.000 (njëqind mije) lekë.
- B. Pranuesi i Dhurimit z. Alket Hyseni është bashkëortak dhe zotërues i 1 (një) kuote e përbër prej 51% (pesëdhjet e një përqind) të kapitalit të shoqërisë "H&A Law Firm" sh.p.k, një shoqëri e themeluar e që funksionon sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, e regjistruar ne Regjistrin Tregtar Shqiptar me NIPT L32319015I, me seli ne adresën: Tirane, Rruga e Barrikadave, Godina "Turdiu Center", Kati 6, Ap.4, vlera e kapitalit të së cilës është 100.000 (njëqind mijë) lekë
- C. Dhuruesi dëshiron ti dhuroj pranuesit të dhurimit, bashkëortak në këtë shoqëri, dhe ky i fundit dëshiron të pranoj nga ana e dhuruesit 1 (një) kuotë e përbërë nga 49% (dyzet e nëntë përqind) të kapitalit të Shoqërisë, duke e bërë pranuesin e dhurimit në mënyrë ortak i vetëm në shoqëri;
- D. Në përputhje me Statutin e Shoqërisë dhe Ligjin Nr. 9901/2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, si dhe me vendimin bashkëlidhur te Ortakut te Vetem te Shoqërisë, Palët dëshirojnë te lidhin këtë Kontrate.

Neni 1

Objekti

Dhurimin i një kuote të Shoqërise Tregtare "H&A Law Firm sh.p.k e zotëruar nga z. Namik Hyseni e përbër nga 49% (dyzet e nëntë përqind) të kapitalit të shoqëris drejt përfituesit të dhurimit z. Alket Hyseni, duke e bërë këtë të fundit ortak të vetëm të shoqërisë.

Gjithashtu me dhurimin e këtyre kuotave, dhuruesi i kalon për llogari të pranuesit të dhurimit të gjitha të drejtat dhe detyrimet të ka zotëruar dhe zotëron në shoqëri.



Me nënshkrimin e këtij akti dhe depozitimin e akteve, në QKB, shoqëria "H&A Law Firm sh.p.k përbëhet nga një ortak i vetëm:

- z. Alket Hyseni, zoterues i një kuote të vetme të përbër nga 100% (njëqind përqind) të kapitalit.

Neni 2

Baza Ligjore

Neni 761 e vijues te Kodit Civil

Neni 73, pika 1. germa "ç" (për kuotat e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar ose neni 117. pika 1, germa "c" (për aksionet e shoqërive aksionare/anonime) te Ligjit nr. 9901, date 14.08.2009 'Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare ', i ndryshuar.

Neni 3

Deklarimet dhe Garancitë e Dhuruesit

Në datën e nënshkrimit të kësaj kontrate, Dhuruesi i kuotes deklaron se zotëron 49% (dyzet e nëntë përqind) në kapitalin e shoqërisë përmes kuotës që zotëron në këtë shoqëri. Kuota është e lirë nga cdo barrë dhe detyrim dhe se dhuruesi i saj ka të drejtë të plotë për ta dhuruar atë në cdo kohë. Në momenin e nënshkrimit të kësaj kontrate pranuesi i dhurimit do të fitojë të gjitha të drejtat ligjore mbi këtë kuotë. Miratimi për dhurimin e kuotës është dhënë në përputhje me legjislacionin përkatës. Dhuruesi pranon se me nënshkrimin e kësaj kontrate kalon në mënyrë të plotë përfutjesit të dhurimit të drejta të parevokueshme në shoqëri. Pranuesi i dhurimit do të ketë të drejtë për të përfutur cdo dividend si dhe cdo të drejtë tjetër financiare që lidhet me shoqërinë dhe që ligji njeh se përfitohen prej saj si dhe cdo detyrim ligjor që ligji parashikon për zoteruesin e kuotës. Dhuruesi nga momenti i nënshkrimit të kontratës nuk do të ketë më asnjë të drejtë mbi kuotën. Të gjitha të drejtat nga dividendi apo cdo formë tjetër përfitimi ligjor para nënshkrimit të kësaj kontrate do ti përkasnin pranuesit të dhurimit ndërsa dhuruesi nuk do të ketë asnjë pretendim për këto përfitime.

Neni 4

Shpenzimet dhe taksat

Të gjitha shpenzimet që lidhen me këtë dhurim kuotash dhe që përbën pasuri të luajtshme do të jenë në ngarkim të dhuruesit dhe pranuesit të dhurimit siç parashikon përkatësish ligji.

Neni 5

Dispozitat Përfundimtare

Kjo kontratë do të rregullohet dhe interpretohet në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë. Kontrata përbën marrëveshjen e plotë midis palëve në lidhje me objektin e saj dhe ka epersi mbi cdo marrëveshje të mëparshme me gojë apo me shkrim, midis palëve. Nuk ka asnjë deklaram nxitje premtim

deklarim të qëllimit apo marrëveshje, me gojë apo me shkrim, midis palëve, të cilat mund të kenë ndonjë efekt apo pasojë mbi marrëveshjen dhe që nuk është përfshirë në kontratë. Kontrata nuk do të ndryshohet, zëvendësohet apo shfuqizohet, përveçse me instrument me shkrim të nënshkruar nga të dy palët dhe çdo instrument që ka për qëllim ndryshimin, zëvendësimin apo shfuqizimin e marrëveshjes ose të çdo pjese të saj nuk do të jetë i detyrueshëm dhe nuk do të ketë asnjë efekt përveçse dhe derisa të jetë nënshkruar dhe dorëzuar nga të dy palët.

Në rast se ndonjë nga dispozitat e kontratës është apo shpallet e pavlefshme apo e pazbatueshme, kjo pavlefshmeri apo pazbatueshmeri nuk do të çënojë vlefshmerinë apo zbatueshmerinë e dispozitave të tjera.

Dispozita e pavlefshme do të zëvendësohet me një dispozitë të vlefshme dhe të zbatueshme qëllimi i të cilës i korrespondon qëllimit që palët kanë patur për të transferur përmes kontratës së dhurimit pjesë të zoterimit të kuotës së tyre.

Kjo Kontratë u hartua në 4 (katër) kopje origjinale në gjuhën Shqipe dhe pasi u lexua prej palëve, u gjet e rregullt, në përputhje me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë, u nënshkrua rregullisht nga palët si vijon:

PALËT

DHURUESI
Namik Hyseni

Namik Hyseni

PRANUESI I DHURIMIT
Alket Hyseni

Alket Hyseni
2024

